



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E FINANCE BUXHET DHE KONTABILITET

Nr. 1277 prot

Fier, më 28.01.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 15 datë 28.01 2026.

“Për ngritjen e Komisionit për Trajtimin e Kërkesave për Ndihmë të Menjëhershme dhe për Riparim Banesash pranë Bashkisë Fier

Mbështetur në:

Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 121/2016, ligjit nr. 57/2019, , Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social” akteve nënligjore në fuqi dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 118, datë 11.12.2025, “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028 dhe buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2026”; Kërkesave të vazhdueshme për ndihmë të menjëhershme nga individë dhe familje që ndodhen në vështirësi të theksuara ekonomike dhe sociale si dhe kërkesave për riparimin e banesave,
Ekzekutivi i Bashkisë Fier,

PROPOZON:

1. Të ngrihet Komisioni për Trajtimin e Kërkesave për Ndihmë të Menjëhershme dhe për Riparim Banesash pranë Bashkisë Fier
2. Komisioni ka për detyrë:

- a) Të përcaktojë dhe miratojë kriteret e përfitimit mbi bazë ligjore.
- b) Të shqyrtojë dhe trajtojë kërkesat për ndihmë të menjëhershme, riparim banesash dhe kërkesa të tjera për ndihma të ndryshme.
- c) Të vendosë për dhënien ose mosdhënien e ndihmës dhe masën e saj.
- d) Të administrojë dokumentacionin dhe procesverbalet përkatëse.

3. Komisioni të përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët:

3 (tre) anëtarë nga administrata e Bashkisë Fier,

- a) Natasha Sollaku - **Kryetar**, përfaqësues të shërbimeve sociale
- b) Elvira Qoku -Anëtar, sektori financiar
- c) Denisa Azizaj- Anëtar, sektorit juridik;

2 (dy) anëtarë nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Fier,

- d) _____ anëtarë i Këshillit Bashkiak
- e) _____ anëtarë i Këshillit Bashkiak

4. Komisioni raporton periodikisht pranë Kryetarit të Bashkisë Fier dhe Këshillit Bashkiak.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

6. Për zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Shërbimit Social të Bashkisë Fier.

Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit
Pranvera Çina

Drejtoria e Shërbimit Social
Me autorizim
SNL. A. MARGILAJ

Drejtoria Juridike
Esmeralda Kapllanaj

KRYETARI
Armando Subashi

